



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore
TITULLI I LËNDËS: BAZAT E NUMIZMATIKËS

Pedagogu: Prof. Dr. Shpresa Gjongecaj-Vangjeli
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: II/I

EKSTRAKT

Numizmatika është një degë e vecantë e Arkeologjisë dhe ka për objekt kryesor studimin e monedhave në antikitet. Monedhat na japin informacione shumë të rëndësishme mbi jetën ekonomike, politike, sociale, religjioze si dhe mbi proceset transformuese që ndodhen në territorin ilir dhe ate epirot përgjate shumë shekujve. Një vend i veçantë i kushtohet në këtë cikël leksionesh diskutimit të reformave të mëdha të realizuara në fushën moneatre. Studimi i monedhave të prera nga qytetet dhe mbretërit ilir por edhe ato të qarkulluara në territorin tone është lidhur me transformimet e brendshme të qyteteve në Iliri në planin e historise politike dhe ekonomike të popullsisë iliro-epirote , e cila e perdorte monedhen , e thesarizonte ate ne momente dhe kushte te veshtira pasigurish. Qarkullimi monetar në vend dhe kontakti i qyteteve në Iliri me botën greke nëpërmjet kolonive helene në bregdetin e Adriatikut janë disa nga çështjet e tjera që do të trajtohen. Gjithashtu roli i rëndësishëm i veprimtarie monetare të Dyrrahut dhe Apollonisë ze një vend të rëndësishëm. Një vend të veçantë do të zënë monedhat e prera nga mbreti ilir Monuni dhe rolin që ai luajti në marrëdhënjet me Dyrrahun dhe Apolloninë dhe më gjërë me Korkyrën. Jashtë aspektit themelor të monedhes si mjet këmbimi ajo do të trajtohet edhe si një dokument historik me vlerë që na ndihmon në identifikimin e qyteteve të panjohura, në përfitim të kronologjive të reja, në intensitetin e prerjeve monetare në periudha të ndryshme dhe në realizimin e reformave monetare. Një pjesë e madhe e orëve mësimore dhe diskutimeve në klasë do të kushtohet anës praktike, të njohjes dhe prekjes së monedhave të prera në territorin shqiptar dhe marrëdhënjeve midis dy kolonive Dyrrahut dhe Apollonisë dhe qyteteve ilire që kanë prera monedha. Përdorimi i monedhës për të përballuar luftat e zhvilluara në territorin ilir krahas denarëve romak do të jete një piksynim tjetër për të treguar peshën që kishte monedha ilire. (në mënyrë të veçantë luftat civile mes Cezarit dhe Pompeut). Adaptimi i sistemit monetar romak nga Apollonia, Foinike, Butrinti etj. në kushte të caktuara politike do të jetë një aspekt tjetër i trajtimit të leksioneve.

TEMAT:

LEKSION 1. Qarkullimi paramonetar

LEKSION 2. Arkeologjia dhe monedhat

LEKSION 3. Numizmatika dhe Historia

LEKSION 4. Monedhat e para te prera ne territorin lir.

LEKSION 5. Aleanca monetare midis Dyrrahut dhe Apollonise

LEKSION 6. Monedhat e qyteteve ilire.

LEKSION 7. Qarkullimi monetar ne shek. V-I p.e.sone.

LEKSION 8. Monedhat e mbreterve ilir.

LEKSION 9. Monedhat e Epirit

LEKSION 10. Marredhenjet midis Dyrrahut, Apollonise qyteteve ilire.

LEKSION 11. Marredhenjet midis dy brigjeve te Adriatikut mbeshtetur mbi monedhen

LEKSION 12. Reforma monetare ne Apolloni ne shekullin I p.e.sone

LEKSION 13. Thesaret.

LEKSION 13. Qarkullimi monetar ne periudhen romake dhe trasformimet politike ne iliri.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjeshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:**Hasan Ceka**

1. Ne kerkim te historise Ilire. Tirane 1998.
2. Monedha te Dyrrahut dhe te Apollonise, Tirane 2008.
3. Probleme te Numizmatikes Ilire, Tirane 1967

Shpresa Gjongecaj

1. Te dhena numizmatike nga Iliria e jugut dhe Epiri i Veriut ne shekujt V-I p.e.s. Iliria 2009-2010.
2. Thesari i Lleshanit, nje ndihmese per politiken monetare te Dyrrahut, Iliria 2005-2006.
3. Te dhena te reja per datimin e denareve apolloniat, Iliria nr. 1-2, 1999-2000.
4. Circolazione delle monete a Phoinike, Phoinike IV, Bologna 2007

Sh. GJONGECAJ-O.PICARD

5. Drachmes d'Apollonia et de Dyrrachion dans le Balkan, Studia Albanica, I, Tirane 2005.

H. NICOLET-PIERRE : Numismatique grecque Paris 2002.

M. H. Crawford : Roman Republican Coinage, Cambridge 1974.

A. BURNETT, M. AMANDRY, P.P.RIPOLLES: Roman Provincial Conage.Pars 1992.

S. ISLAMI : Prerjet monetare te Skodres, Lisit, dhe Gentit, ILIRIA II. 1972, f. 351-376.